EP kategorizohet në EP hemodinamiksht stabile dhe hemodinamiksht instabile. Prania e jostabilitetit hemodinamik është jetëkërcënues dhe kërkon një metodë diagnostike emergjente,

si dhe një trajtim emergjent pas konfirmimit. [3,4]

Vlerësimi i probabilitetit klinik (para-test) për EP bazohet në interpretimin e simptomave dhe shenjave klinike, si dhe në identifikimin e faktorëve predispozues për trombozë të venave të thella. Për të lehtësuar vlerësimin në praktikën klinike, duke marrë parasysh urgjencën që EP paraqet dhe rrezikun jetëkërcënues, janë krijuar skema të standardizuara për llogaritjen e rrezikut, ndër të cilat Wells Rules dhe Geneva Rules janë më të pranuarat gjerësisht. [3]

Diagnoza vendoset me ndihmën e anamnezës, pasqyrës klinike, prezencës/mospresencës së stabilitetit hemodinamik, vlerësimit të probabilitetit klinik, si dhe analizës së gazrave në gjak (pO_2 , pCO_2), EKG-së, Echos me Color Doppler, rentgenit, CTPA - angiografisë pulmonare me tomografi kompjuterike (metoda diagnostike e zgjedhjes së parë), scintigrafisë së perfuzionit/ventilimit, si dhe provës për praninë e TVT-së me ndihmën e ekografisë kompresive me Doppler me ngjyra të venave të poshtme. [2,3]

Nivelet e D-dimerit në plazmë rriten në prani të trombozës akute. Vlera e D-dimerit merret në konsideratë krahas probabilitetit klinik. Udhëzimet e fundit, si ato të ESC 2019, rekomandojnë përdorimin e vlerave të përshtatura të D-dimerit, në varësi të moshës apo nivelit të probabilitetit klinik. [3] Në të njëjtën kohë, vlerat e troponinës T/I me sensitivitet të lartë dhe BNP shërbejnë si parametra prognostikë. [2]




Figura 1. Algoritmi Diagnostik i EP

Korrespondenca:
medinamelenica@gmail.com

Qëllimet e terapisë janë: parandalimi i rezidivimit të EP-së dhe ulja e vdekshmërisë përmes trajtimit të përshtatur sipas nivelit të rrezikut. [2,3]

2. Qëllimi

Ky rishikim literature synon të vlerësojë rëndësinë dhe vlefshmërinë e skemave të vlerësimit të probabilitetit klinik dhe të testit të D-dimerit në diagnostikimin fillestar të embolisë pulmonare, në përputhje me udhëzimet më të fundit ndërkombëtare, si dhe të pajisë me algoritmet diagnostike.

3. Rishikim literature

3.1. Algoritmi diagnostik sipas Udhëzuesit ESC dhe ERS 2019

Algoritmi diagnostik sipas udhëzuesit ESC 2019 sugjeron që te pacientët me probabilitet klinik të ulët/të ndërmjetëm për EP dhe pa prani të jostabilitetit hemodinamik, të bëhet testi i D-dimerit. Ndërsa, te pacientët me probabilitet klinik të lartë, si linjë e parë diagnostike përdoret CTPA.

Në rastet emergjente, te pacientët me probabilitet të lartë për EP dhe instabilitet hemodinamik, nëse gjendja e pacientit është e rëndë dhe kërkon një metodë diagnostike pranë shtratis, atëherë prania e një disfunksioni të ventrikulit të djathtë me ndihmën e ekokardiografisë transesofageale e konfirmon diagnozën dhe duhet të fillohet menjëherë me terapi stabilizuese. Pas stabilizimit të gjendjes,

duhet kërkuar konfirmimi i diagnozës me CTPA. [9-12]

3.2. Diagnostika imazherike

Shenjat e TTE të embolisë pulmonare akute:

•Dilatim i barkushes së djathtë (RV) me raport bazal RV/LV > 1.0 dhe shenja e McConnell (hipokinezi e murit të mesëm lateral me ruajtje të kontraktilitetit në majë).

•Shtypje (rrafshim) e septumit ndërventrikular (formë "D" e barkushes së majtë).

•Dilatim i venës kava inferiore (IVC) me ulje të kolapsit gjatë frymëmarrjes.

•Shenja "60/60": Bashkëekzistenca e kohës së përshpejtit të ejectionit pulmonar (AcT) < 60 ms dhe prania e një "gropëze" mes-sistolike, me gradient sistolik maksimal në valvulën trikuspide < 60 mmHg.

•Prani e një trombi lëvizës në zemrën e djathtë (RiHTh) - e zbuluar në kavitetet të zemrës së djathtë.

Radiografia

Ndryshimet në radiografi për EP janë jospesifike dhe kjo imazheri përdoret kryesisht për të eliminuar shkaqe të tjera të sëmundjeve torakale që mund të manifestohen me dhimbje gjoksi dhe dispne. [2,3]

Ekokardiografia (EKG)

Ndryshimet në EKG vijnë si rezultat i

sforcimit të ventrikulit të djathtë, ndonëse shpesh ato mund të jenë jospesifike edhe për një emboli masive. Karakteristik është tipi SI-QIII ose S₁S₂S₃. Pasqyrimi i EP-së në EKG mund të shfaqet si çrregullim i përçimit të ritmit (bllok komplet ose inkomplet i ventrikulit të djathtë) ose si çrregullim i repolarizimit (ulje e segmentit ST dhe rrafshim i valës T). Në EP akute mund të hasim tahikardi sinusale (rreth 90%) dhe një valë P-dextroatriale. [13]

CTPA

CTPA paraqet standardin e artë në diagnostikimin e EP-së. Sipas studimit PIOPE II (The Prospective Investigation on Pulmonary Embolism Diagnosis), specifteti i CTPA është 96% dhe sensitiviteti 83%. [14]

3.3. Roli i probabilitetit klinik para diagnostikës imazherike - Wells Rule & Geneva Rule

Duke qenë se simptomat për një EP janë jospesifike, kërkimi për një EP te çdo pacient me dispne dhe dhimbje gjoksi do të krijonte kosto shumë të larta, efekte anësore të testeve diagnostike dhe vonës në vendosjen e diagnozës në mënyrë efektive. Për të shmangur këtë problematikë, si dhe përdorimin e metodave diagnostike imazherike si CTPA, bashkë me efektet anësore dhe rreziqet përkatëse, janë bërë përpjekje për të arritur një vlerësim klinik të probabilitetit për një EP përpara se të përdoren testet e tjera diagnostike.

Tabela 2. Geneva-Rule

Geneva Rule	Pikët	
	Versioni origjinal	Versioni i thjeshtësuar
Emboli pulmonare ose trombozë venoze e thellë e mëparshme	3	1
Ritmi i zemrës		
75-94 b.p.m.	3	1
≥95 b.p.m.	5	2
Operacion ose frakturë gjatë muajit të fundit	2	1
Hemoptizi	2	1
Kancer aktiv	2	1
Dhimbje njëanëshe e gjymtyrës së poshtme	3	1
Dhimbje gjatë palpimit të venave të thella dhe edemë njëanëshe	4	1
Mosha >65 vjeç	1	1
Probabiliteti klinik		
Tre nivele		
I ulët	0-3	0-1
I ndërmjetshëm	4-10	2-4
I lartë	≥11	≥5
Dy nivele		
PE-gjasa të vogla/e pamundur	0-5	0-2
PE-ka gjasa të jetë EP	≥6	≥3

Për këtë qëllim përdoret vlerësimi i probabilitetit klinik. Ky vlerësim mund të bëhet me gjykim klinik, zakonisht me ndihmën e EKG-së dhe radiografisë, ose mund të shfrytëzohen vlerësimet e standardizuara të probabilitetit klinik para-test. Më të pranuarat gjerësisht janë Geneva Score dhe Wells Score, të cilat përdorin një kombinim të simptomave dhe shenjave klinike, faktorëve predispozues, moshës, si dhe historisë së paraprahe.

Këto teste kategorizojnë rastet me dyshim për EP në dy mënyra:

- Probabiliteti me tri nivele - pacient me probabilitet të ulët, mesatar dhe të lartë për EP.

- Probabiliteti me dy nivele - pacient me gjasë për EP dhe pacient pa gjasë për EP.

Ky lloj vlerësimi, në shumë studime, ka treguar rezultate mjaft të mira. Sipas algoritmit diagnostik, te pacientët me probabilitet të ulët dhe të mesëm, në vijim përcaktohet niveli i D-dimerit si linjë e parë diagnostike, ndërsa CTPA është linjë e dytë. [3,16]

Pavarësisht se cila metodë vlerësuese e probabilitetit është përdorur, është e pritshme që rreth 10% e pacientëve nga kategoria me probabilitet të ulët, 30% nga kategoria me probabilitet mesatar dhe 65% nga kategoria me probabilitet të lartë të konfirmohen me EP. [15]

D-dimeri dhe vlerësimi i probabilitetit

klinik funksionojnë krahas njëri-tjetrit për një qasje më efektive diagnostike dhe rrjedhimisht edhe terapeutike. Në bazë të Wells dhe Geneva Scores, një probabilitet i ulët me një D-dimer ≤ 1000 ng/mL, ose një probabilitet i ndërmjetëm me një D-dimer ≤ 500 ng/mL, tregon për një PE pak të mundshme; në të kundërtën, tregon për një PE të mundshme. [3,16]

Në një meta-analizë të fundit që vlerësoi strategjitë diagnostike që kombinonin vlerësimin klinik të probabilitetit me testimin e D-dimerit, sensitiviteti i Wells Score në kombinim me D-dimerin e rregulluar sipas probabilitetit para-test (PTP) varioonte nga 93.25% deri në 97.11%, ndërsa specifiteti varioonte nga 39.50% deri në 67.40%. Geneva Score në kombinim me D-dimerin kishte një sensitivitet prej 94.2% deri në 95.7% dhe specifitet prej 37.3% deri në 54.5%. [16]

3.4. Relevanca e D-dimerit

D-dimeri është nënprodukt i fibrinës, i cili formohet pas shpërbërjes së fibrinës nga plazmina dhe paraqet një marker të koagulimit dhe fibrinolizës. Kur ndodh një dëmtim i enës së gjakut, trombina e shndërron fibrinogjenin në fibrinë. Fibrina krijon rrjetën e saj, e cila e stabilizon mpiksjen. Kur një mpiksje nuk është më e nevojshme, plazmina e shpërbën rrjetën e fibrinës, duke krijuar fragmente të shpërbërjes së fibrinës, të cilat quhen D-dimer.

Në kushte normale, trupi ruan ekuilibrin mes formimit dhe shpërbërjes së mpiksjeve, çka e mbron nga gjakderdhja e tepërt. D-dimeri ka një gjysmë jete prej 6-8 orësh dhe eliminohet nga veshkat dhe sistemi retikuloendotelial. [17]

Testi i D-dimerit ka sensitivitet të lartë, por specifitet të ulët, duke rezultuar në vlerë parashikuese negative të lartë. Prandaj, vlerat normale të D-dimerit në plazmë shërbejnë për të përjashtuar një EP ose TVT si të mundshme. Në anën tjetër, vlera parashikuese pozitive është e ulët, prandaj rritja e nivelit të tij në plazmë nuk përdoret për konfirmimin e diagnozës së EP apo TVT. [17] Sipas disa studimeve, te pacientët me D-dimer negativ, të cilët nuk janë trajtuar, pas 3 muajsh rreziku për emboli ka rezultuar $<1\%$. [18]

Vlera normale e D-dimerit është nën 500 ng/mL ose 0.50 $\mu\text{g/mL}$. D-dimeri pozitiv është 500 ng/mL ose mbi këtë vlerë dhe kërkon të vazhdohet me diagnostikim imazherik me CTPA ose skanimin e ventilimit/perfuzionit (V/Q scan). Te pacientët me probabilitet të lartë klinik, nuk rekomandohet përcaktimi i D-dimerit; në këto raste duhet të vazhdohet drejtpërdrejt me imazheri diagnostike. [17]

Testi imunosorbent sasior i lidhur me enzimë (ELISA) ka një sensitivitet diagnostik mbi 95% dhe, së bashku me probabilitetin klinik, mund të përjashtojë EP pa kryer teste të tjera diagnostike në 30% të pacientëve. [3]

Tabela 3. Wells Rule

Wells Rule	Pikët	
	Versioni origjinal	Versioni i thjeshtësuar
Emboli pulmonare ose trombozë venoze e thellë e mëparshme	1,5	1
Ritmi i zemrës >100 b.p.m.	1,5	1
Operacion ose imobilizim gjatë muajit të fundit	1,5	1
Haemoptizi	1	1
Kancer aktiv	1	1
Shenja klinike për TVT	3	1
Nuk ka gjasa për një diagnozë alternative	3	1
Probabiliteti klinik		
Tre nivele	0-1	N/A
I ulët	2-6	N/A
I ndërmjetshëm	≥ 7	N/A
I lartë		
Dy nivele		
PE-gjasa të vogla/e pamundur	0-4	0-1
PE-ka gjasa të jetë EP	≥ 5	≥ 2

Specifiteti i testit të D-dimerit ulet me mbi 10% te pacientët mbi 80 vjeç, duke çuar në rezultate pozitive jo të sakta. [3]

Sipas Righini et al. (2014), përdorimi i kufijve të D-dimerit të rregulluar sipas moshës (i llogaritur si mosha $\times 10 \mu\text{g/L}$ për pacientët mbi 50 vjeç) përmirëson saktësinë diagnostike dhe rrit numrin e pacientëve të cilët EP mund të përjashtohet pa nevojë për imazheri diagnostike, krahasuar me vlerën fikse prej $500 \mu\text{g/L}$.

Në grupin e pacientëve ≥ 75 vjeç, përqindja e atyre të cilët EP u përjashtua vetëm me testin e D-dimerit u rrit nga 6.4% në 29.7%, ndërkohë që shkalla e dështimit mbeti shumë e ulët (0.3%) gjatë ndjekjes tremujore. [19]

Limitet e D-dimerit janë specifiteti i ulët dhe vlerat pozitive shpesh jo të sakta. Në rritjen e vlerave të D-dimerit ndër të tjera ndikojnë shtatzënia, infeksionet, mosha e shtyrë, hospitalizimet e gjata, malinjitetet, ndërhyrjet kirurgjikale, sëmundjet e mëlçisë, kontrceptivët oralë dhe sëmundjet autoimmune. [17]

4. Metodologjia

Ky punim është një rishikim literature. Të dhënat janë marrë nga literatura më e fundit dhe bashkëkohore, duke u bazuar në udhëzuesit ESC dhe ERS, si dhe në studime e metaanaliza të rëndësishme. Burimet janë listuar në kapitullin e referencave dhe janë cituar në tekst.

5. Rezultate dhe diskutimi

Kombinimi i vlerësimit të probabilitetit klinik para-test me testin e D-dimerit përmirëson ndjeshëm saktësinë diagnostike, si dhe ul nevojën për imazheri të panevojshme në diagnostikimin e embolisë pulmonare.

Testi i D-dimerit i bazuar në metodën ELISA ka sensitivitet mbi 95% dhe vlerë parashikuese negative të lartë, duke mundësuar përjashtimin e sigurt të EP në rreth 30% të pacientëve me probabilitet të ulët klinik.

Në studimin ADJUST-PE (Righini et al., 2014), përdorimi i kufirit të D-dimerit të rregulluar sipas moshës (mosha $\times 10 \mu\text{g/L}$) rriti përjashtimin e sigurt të EP te pacientët ≥ 75 vjeç nga 6.4% në 29.7%, me shkallë dështimi vetëm 0.3%.

Këto të dhëna konfirmojnë se kombinimi i vlerësimit klinik me D-dimerin të përshtatur sipas moshës përmirëson ndjeshëm diagnostikimin fillestar dhe zvogëlon përdorimin e panevojshëm të imazherisë.

6. Përfundimi

Embolia pulmonare mbetet një urgjencë mjekësore me potencial të lartë letaliteti, ndaj vendosja e shpejtë dhe e saktë e diagnozës është thelbësore për uljen e vdekshmërisë dhe komplikimeve.

Kombinimi i vlerësimit të probabilitetit klinik para-test (sipas skemave të Wells dhe Geneva), së bashku me testin e D-dimerit, përbën një qasje thelbësore për optimizimin e diagnostikimit

fillestar. Testi i D-dimerit kryhet te pacientët me probabilitet klinik të ulët dhe të ndërmjetëm, ndërsa te pacientët me probabilitet të lartë nuk rekomandohet. Në këto raste duhet të procedohet drejtpërdrejt me imazheri diagnostike si CTPA ose V/Q scan.

Integrimi i vlerësimit të probabilitetit klinik me përdorimin e D-dimerit të rregulluar sipas moshës përfaqëson një strategji të bazuar në evidencë, që rrit saktësinë diagnostike, ul ekspozimin ndaj imazherisë së panevojshme dhe përmirëson menaxhimin racional të pacientëve me dyshim për emboli pulmonare.

Referencat:

1. Konstantinides SV, Meyer G, Becattini C, et al. 2019 ESC Guidelines for the diagnosis and management of acute pulmonary embolism developed in collaboration with the European Respiratory Society (ERS). *Eur Heart J*. 2020;41(4):543–603.
2. Herold G. *Innere Medizin 2025: eine vorlesungsorientierte Darstellung*. Köln: Gerd Herold Verlag; 2024.
3. Konstantinides SV, Meyer G, Becattini C, Bueno H, Geersing G-J, Harjola V-P, Huisman MV, Humbert M, Jennings CS, Jiménez D, Kucher N, Lang IM, Lankeit M, Lorusso R, Mazzolai L, Meneveau N, Ní Áinle F, Prandoni P, Pruszczyk P, Righini M, Torbicki A, Van Belle E, Zamorano J-L, et al. 2019 ESC Guidelines for the diagnosis and management of acute pulmonary embolism developed in collaboration with the European Respiratory Society (ERS). *Eur Heart J*. 2020;41(4):543–603.
4. Vyas V, Sankari A, Goyal A. Acute pulmonary embolism. In: StatPearls [Internet]. Treasure Island (FL): StatPearls Publishing; 2025 Jan-. Last update Dec 11 2024. Available from: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK560551/>
5. Pollack CV, Schreiber D, Goldhaber SZ, Slattery D, Fanikos J, O'Neil BJ, Thompson JR, Hiestand B, Briesse BA, Pendleton RC, Miller CD, Kline JA. Clinical characteristics, management, and outcomes of patients diagnosed with acute pulmonary embolism in the emergency department: initial report of EMPEROR (Multicenter Emergency Medicine Pulmonary Embolism in the Real World Registry). *J Am Coll Cardiol*. 2011;57(6):700–706. doi:10.1016/j.jacc.2010.05.071
6. Miniati M, Prediletto R, Formichi B, Marini C, Di Ricco G, Tonelli L, Allessia G, Pistolesi M. Accuracy of clinical assessment in the diagnosis of pulmonary embolism. *Am J Respir Crit Care Med*. 1999;159(3):864–871.
7. Ellis PS, Ginsberg JS, Anderson DR, Kearon C, Gent M, Turpie AG, Bormanis J, Weitz J, Chamberlain M, Bowie D, Barnes D, Hirsh J. Use of a clinical model for safe management of patients with

KUJDESI EMERGJENT NË SEPSË DHE SHOK SEPTIK - NGA PROTOKOLLET TE STRATEGJITË AFATGJATA



Rrezarta Begolli

Doktor i Mjekësisë

Abstrakti

Sepsa është një shqetësim global shëndetësor dhe një urgjencë mjekësore, e përcaktuar si përgjigje sistematike imunologjike e trupit ndaj një infeksioni i cili mund të çojë në mosfunksionim të rëndë të organeve dhe vdekje. Ky kuptim ka evoluar pjesërisht për shkak të përparimeve në njohuritë tona për patofiziologjinë e saj. Qëllimi i këtij rishikimi është të shqyrtojë përparimet e fundit në trajtimin e sepsës dhe shokut septik. Prandaj, rishikuam literaturën aktuale mbi sepsën, duke analizuar përparimet në përkufizimet e saj, udhëzimet e trajtimit dhe strategjitë e menaxhimit. Udhëzimet aktuale të Fushatës së Mbijetesës së Sepsës (SSC) rekomandojnë trajtimin e hershëm me lëngje, terapi të menjëhershme me antibiotik dhe monitorimin e klirensit të laktatit.

Si përfundim, iniciimi i trajtimit fillestar është një komponent kritik i menaxhimit të sepsës dhe shokut septik, duke ndikuar ndjeshëm në rezultatet e pacientëve. Ndërsa kuptimi ynë për sepsën vazhdon të evoluojë, hulumtimet dhe diskutimet e vazhdueshme rreth këtyre udhëzimeve mbeten thelbësore për përmirësimin e protokolleve të trajtimit dhe rritjen e kujdesit ndaj pacientit. Duke pasur parasysh rolin vendimtar të përgjigjes imune në patofiziologjinë e sepsës, hulumtimet e ardhshme mbi menaxhimin e sepsës ka të ngjarë të përqendrohen në mekanizmat anti-inflamatorë.

Fjalët kyçe: shoku septik, vazopresorë, sepsë, terapi me antibiotik, vdekshmëri.


Hyrje

Sepsa është një sindromë kërcënuese për jetën e karakterizuar nga një përgjigje jonormale ndaj infeksionit, që çon në mosfunksionim të

organeve. Edhe pse patofiziologjia themelore e kësaj gjendjeje klinike është kuptuar më mirë me kalimin e viteve dhe janë bërë përparime në monitorimin hemodinamik dhe masat e ringjalljes, sepsa është ende një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë dhe morbiditetit mes pacientëve në gjendje kritike. (6)

Përkufizimi formal i sepsës i referohet një procesi kompleks patofiziologjik në të cilin një patogjen shkakton një përgjigje fillestare të ekzagjeruar imuno-inflamatorë. Kjo përgjigje e shtuar çon në aktivizimin ose supresionin e shumë rrugëve biokimike, duke rezultuar në çrregullim të funksionit cirkulator dhe metabolik. Klinikisht, sepsa zakonisht përcaktohet si prania e infeksionit së bashku me të paktën dy nga katër kriteret e Sindromës së Përgjigjes Inflamatorë Sistematike (SIRS). Kur sepsa çon në mosfunksionim të organeve, ajo klasifikohet si sepsë e rëndë. Si rezultat i kësaj përgjigjeje të vazhdueshme të çrregulluar është paqëndrueshmëria hemodinamike pavarësisht trajtimit, e klasifikuar në fund si "shoku septik", i karakterizuar nga kolaps i rëndë cirkulator dhe oksigjenim i dëmtuar i indeve. Prandaj, shoku septik mbetet një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë në mbarë botën. (2,8)

Studimi EPIC II i vitit 2009 mbi prevalencën e infeksioneve në kujdesin intensiv në Evropë, përcaktoi se infeksionet bakteriale gram-negative janë shkak i zakonshëm i sindromave të sepsës, me një frekuencë prej 62%, të ndjekura nga infeksionet gram-pozitive me 47%. Mikroorganizmat më të shpeshtë të izoluar tek pacientët përfshijnë *Staphylococcus aureus* (20%), *Pseudomonas* (20%) dhe *Escherichia coli* (16%). Vendet mbizotëruese të infeksionit përfshijnë rrugët e frymëmarrjes (42%), qarkullimin e gjakut (21%) dhe sistemin



[NLP]: Data extracted using natural language processing applied to provider notes (unstructured sources)

Figura 1. Evulimi nga SIRS tek shoku septik. (Burimi: Mdpi.com. [cited 2025 Oct 30]. Available from: <https://www.mdpi.com/2077-0383/10/2/301>).

KUJDESI EMERGJENT NË SEPSË DHE SHOK SEPTIK - NGA PROTOKOLLET TE STRATEGJITË AFATGJATA



Krenare Makolli

*Specialist i Mjekësisë
Emergjente*

gjenitourinar (10%). Megjithatë, bakteremia gram-pozitive me *Acinetobacter* ose pneumonia me *Staphylococcus* bart një vdekshmëri prej 40%, ndërsa pneumonia pseudomonale bart vdekshmërinë më të lartë me 70%. (9)

Rreziku i shokut septik rritet te pacientët me sistem imunitar të dobësuar, të porsalindurit, personat mbi moshën 65 vjeç, gratë që janë shtatzëna, kanë lindur ose kanë pasur ndërprerje të shtatzënisë ose abort spontan në 6 javët e fundit si dhe përdoruesit e substancave narkotike. (5)

Në një studim që krahasoi pacientët e diagnostikuar me sepsë të rëndë ose shok septik në grupet e të moshuarve dhe jo të moshuarve, u zbulua se faktorët e rrezikut si pirja e duhanit, përdorimi i medikamenteve, hiperglikemia dhe dështimi i shumëfishtë i organeve rritën ndjeshëm rrezikun e sepsës tek pacientët e moshuar. Në të kundërt, dështimi kronik i veshkave, tumoret hematologjike malinje dhe leukopenia u identifikuan si faktor rreziku më të spikatur tek pacientët jo të moshuar. (6)

Shenjat klinike dhe mjetet e indentifikimit të hershëm të sepsës

Shenjat dhe simptomat e sepsës janë shumë të ndryshueshme dhe një diagnozë klinike shpesh bëhet para se të jenë të disponueshme rezultatet e kulturës. Historia e pacientit duhet të përqendrohet në simptomat, ndërhyrjet kirurgjikale të kohëve të fundit, sëmundjet themelore, historinë e përdorimit të antibiotikëve të kohëve të fundit dhe udhëtimet. (10)

Komponentët kryesor të ekzaminimit fizik përfshijnë shenjat jetësore (p.sh., ethe, hipoksi, hipotension), lëkurën (p.sh., furunkula ose

karbunkula, ulçera, celuliti, vendet intravenoze, ekimoza ose petekie), sistemin pulmonar (p.sh., takipnea, hiperventilimi, kolla, hemoptizia, ronki ose rale, egofoni), sistemin gastrointestinal (p.sh., dhimbje barku, hipomotilitet i zorrëve, diarre), sistemin gjenitourinar (p.sh., ndjeshmëri suprapubike, ndjeshmëri kostovertebrale), sistemin kardiovaskular (p.sh., takikardi, zhurmë) dhe sistemin neurologjik (p.sh., gjendje mendore e ndryshuar). (10)

Ethet janë manifestimi më i zakonshëm i sepsës. Mungesa e etheve dhe hipotermisë së shkaktuar nga sepsa është më e mundshme tek pacientët në moshë ekstreme, pacientët e dobësuar, pacientët me abuzim kronik me alkoolin dhe pacientët me uremi. Hipotensioni është anomalia kryesore në afërsisht 40% të pacientëve me sepsë. Pacientët me imunitet të kompromentuar dhe ata me neutropeni shpesh nuk kanë një burim të dukshëm infeksioni. (10)

Në Departamentin e Emergjencës janë zhvilluar dhe testuar disa mjete shqyrtimi për të ndihmuar në identifikimin e hershëm të sepsës, duke përfshirë: Vlerësimin e Shpejtë të Dështimit Sekuencial të Organeve (qSOFA), kriteret SIRS, Rezultati Kombëtar i Paralajmërimit të Hershëm (NEWS) dhe Rezultati i Modifikuar i Paralajmërimit të Hershëm (MEWS).

Për të diagnostikuar sepsën, duhet të përmbushen të paktën dy nga katër kriteret SIRS. Megjithatë, për shkak se SIRS mund të shkaktohet nga një sërë shkaqesh infektive dhe jo-infektive, ai nuk është mjaftueshëm i ndjeshëm dhe sigurisht jo specifik për sepsën. Prandaj, disa pacientë që plotësojnë kriteret SIRS mund të mos kenë sepsë dhe anasjelltas. Midis këtyre, përkufizimi Sepsis-3 prezantoi qSOFA




Figura 2. Përkufizimi i SIRS dhe qSOFA. SIRS-Sindroma e Përgjigjes Inflammatorë Sistemike; qSOFA - Vlerësimi i Shpejtë i Dështimit Sekuencial të Organeve; WBC-qelizat e bardha të gjakut. (Burimi: Kim HI, Park S. Sepsis: Early recognition and optimized treatment. Tuberc Respir Dis (Seoul) [Internet]. 2019;82(1):6-14. Available from: <http://dx.doi.org/10.4046/trd.2018.0041>).

si mjetin e preferuar të shqyrtimit për zbulimin e hershëm të sepsës. qSOFA është një version i thjeshtuar i rezulttit SOFA që përfshin vetëm tre variabla, dhe pacientët me një rezultat qSOFA prej ≥ 2 duhet të merren në konsideratë për mundësinë e sepsës. Megjithatë, përdorimi i qSOFA është debatuar me udhëzimet e SSC për vitin 2021 që sugjerojnë kundër përdorimit të tij ekskluziv dhe përdorimin e SIRS, NEWS ose MEWS. (2,11)

Provat klinike tregojnë se pacientët me përkeqësim akut ose sepsë shfaqin shenja ose simptoma klinike disa orë para se gjendja të përkeqësohet. Rezultatet e paralajmërimit të hershëm, të tilla si: Rezultati i Modifikuar i Paralajmërimit të Hershëm (MEWS) ose Rezultati Kombëtar i Paralajmërimit të Hershëm (NEWS), u zhvilluan për të shqyrtuar pacientët me rrezik të lartë përkeqësimi. (11)

Kujdesi emergjent dhe protokollet aktuale

Menaxhimi i hershëm i sepsës dhe shokut septik është thelbësor për prognozën e pacientëve. Meqenëse Departamenti i Emergjencës është vendi ku ka të ngjarë të ndodhë kontakti i parë mjekësor për pacientët me sepsë, mjekët e emergjencës luajnë një rol thelbësor në fazat e hershme të menaxhimit të pacientit. (1)


Prioriteti i parë në menaxhimin e hershëm të sepsës është stabilizimi i frymëmarrjes dhe oksigjenimi i pacientit. Oksigjenimi plotësues duhet të administrohet në të gjithë pacientët me sepsë dhe shok septik, me qëllim të ruajtjes së saturimit adekuat të oksigjenit në gjak. Ventilimi mekanik rekomandohet në ato situata ku oksigjeni plotësues nuk mund të sigurojë oksigjenim të mjaftueshëm, në rastet kur dështimi respirator është afër ose kur mbrojtja e rrugëve të frymëmarrjes është e pamundur. Pas stabilizimit fillestar të frymëmarrjes, trajtimi përbëhet nga administrimi i lëngjeve intravenoze,

terapia me vazopresorë, identifikimi dhe kontrolli i infeksionit, administrimi i shpejtë i antibiotikëve dhe terapia me kortikosteroide. (10)

EGDT (Early goal-directed therapy), e prezantuar fillimisht nga Rivers et al. në një provë historike të vitit 2001, revolucionarizoi qasjen ndaj menaxhimit të sepsës duke mbrojtur optimizimin e hershëm dhe agresiv hemodinamik. Kjo qasje u përqendrua në arritjen e objektivave specifike fiziologjike, duke përfshirë presionin mesatar arterial (MAP), saturimin e oksigjenit venoz qendror (ScvO₂) dhe presionin venoz qendror (CVP), brenda gjashtë orëve të para të ringjalljes. Nguyen et al.¹⁸ theksuan se fillimi i hershëm i EGDT çoi në përmirësimin e normave të mbijetesës, një koncept që formoi bazën e udhëzimeve pasuese, të tilla si ato të Fushatës së Mbijetesës së Sepsës (SSC). (3,6)

Fushata e Mbijetesës së Sepsës (SSC) ka qenë instrument në standardizimin e kujdesit ndaj sepsës në mbarë botën. Përditësimi i vitit 2018, i prezantuar nga Levy et al., theksoi nevojën për ndërhyrje në kohë dhe të orientuar drejt qëllimit brenda orëve të para të diagnozës së sepsës. Këto ndërhyrje përfshijnë monitorimin e niveleve të laktatit në serum, marrjen e kulturave të gjakut, administrimin e antibiotikëve me spektër të gjerë dhe sigurimin intravenoz të kristaloideve për të siguruar perfuzion të përshtatshëm të indeve tek pacientët hipotensivë. Këto ndërhyrje, të referuara kolektivisht si paketat 3-orëshe dhe 6-orëshe, kanë treguar se përmirësojnë rezultatet e pacientëve duke minimizuar kohën deri në trajtimin përfundimtar tek pacientët me sepsë. (6)

Trajtimi me lëngje intravenoze është një gurthemel i trajtimit fillestar për sepsën. Udhëzimet e SSC rekomandojnë administrimin e 30 mL/kg kristaloideve intravenoze brenda tre orëve të para për pacientët me hipotension ose një nivel laktat ≥ 4 mmol/L. Objektivi është të rivendoset perfuzioni adekuat i indeve dhe shpërndarja e oksigjenit, duke parandaluar kështu mosfunksionimin e mëtejshëm të organeve. Megjithëse studimet theksojnë rëndësinë e ringjalljes me lëngje, duke treguar se administrimi i hershëm dhe adekuat i lëngjeve shoqërohet me mbijetesë të përmirësuar, udhëzimet gjithashtu paralajmërojnë kundër përdorimit të tepërt të lëngjeve, i cili mund të çojë në mbingarkesë me lëngje dhe rritje



*—If mean arterial pressure is < 65 mm Hg, give vasopressors to maintain pressure at ≥ 65 mm Hg; if mean arterial pressure is > 90 mm Hg, give vasodilators until pressure is ≤ 90 mm Hg.

Figura 3. Nëse presioni mesatar arterial është < 65 mmHg, jepni vazopresorë për të mbajtur presionin mbi 65 mmHg. Nëse presioni mesatar arterial është > 90 mmHg, jepni vazodilatatorë derisa presioni të bie nën 90 mmHg. (Burimi: Gauer RL. Early recognition and management of sepsis in adults: the first six hours. Am Fam Physician [Internet]. 2013 [cited 2025 Oct 30];88(1):44-53. Available from: <https://www.aafp.org/pubs/afp/issues/2013/0701/p44.html>).

të morbiditetit, veçanërisht tek pacientët me gjendje të mëparshme kardiake ose renale. Si tretësisht kristaloide ashtu edhe ato koloide luajnë një rol qendror në menaxhimin e sepsës dhe shokut septik. (6,7)

Terapia empirike me antibiotik me spektër të gjerë ka rol kyç në menaxhimin e sepsës së rëndë dhe shokut septik. Udhëzimet e SSC rekomandojnë administrimin antimikrobik bazuar në faktorë të tillë si: vlerësimi klinik i procesit të mundshëm infektiv, dyshimi për stafilokokun aureus rezistent ndaj meticilinës (MRSA) ose organizmat rezistent ndaj shumë barnave (MDR), dhe burimet e mundshme virale ose kërpudhore. Mbulimi me spektër të gjerë duhet të fillojë brenda një ore nga njohja e shokut septik, ose brenda tre orëve nëse sepsa është e pranishme pa shok. Hulumtimi nga Ferrer et al. zbuloi se çdo orë vonesë në administrimin e antibiotikëve gjatë sepsës së rëndë dhe shokut septik shoqërohej me një rritje të konsiderueshme të vdekshmërisë. (2)

Sipas përkufizimeve të Sepsis-3, pacientët me shok septik mund të identifikohen klinikisht nga nevoja për medikamente vazoaktive. Në këtë drejtim, si udhëzimet e SSC të vitit 2016 ashtu edhe paketa e SSC e vitit 2018 rekomandojnë administrimin e hershëm të vazopresorëve tek pacientët me sepsë hipotensiv për të rikthyer tonin arterial të dëmtuar rëndë. Norepinefrina (NE) rekomandohet si agjenti vazoaktiv i linjës së parë në menaxhimin e pacientëve me shok septik. Veprimi i saj vazokonstriktor ushtrohet nëpërmjet stimulimit të receptorëve α_1 -adrenergjik, me pak ndikim në ritmin e zemrës. (1,4)

Epinefrina është një tjetër vazopresor i linjës së dytë i rekomanduar nga SSC e vitit 2016, përdorimi i të cilit duhet të merret në konsideratë në rast të mosfunksionimit të njëkohshëm kardiak. Dopamina, e cila ishte rekomanduar nga udhëzimet e mëparshme, nuk duhet të përdoret në menaxhimin e pacientëve septikë as si vazopresor dhe as në doza të ulëta, si agjent mbrojtës i veshkave. Është treguar se përdorimi i saj shoqërohet me një rrezik në rritje të aritmive kardiake dhe vdekshmërisë, krahasuar me NE. Aktualisht, përdorimi i saj rekomandohet vetëm në rast të bradikardisë. (1)

Një tjetër fushë polemike në menaxhimin e sepsës është përdorimi i kortikosteroideve, veçanërisht tek pacientët që kërkojnë mbështetje me vazopresorë. Një regjim i përdorur zakonisht është hidrokortizoni, me një dozë tipike prej 200 mg/ditë, i administruar ose si 50 mg çdo 6 orë ose nëpërmjet infuzionit të vazhdueshëm. Ky regjim është përgjithësisht i rezervuar për pacientët tek të cilët vazopresorët mbeten të nevojshëm pavarësisht ringjalljes adekuate të vëllimit. (2)

Metodologjia

Ky punim është bërë përmes grumbullimit dhe rishikimit të literaturës ekzistuese shkencore mbi sepsën dhe shokun septik. Janë analizuar një numër i gjerë i artikujve kërkimorë, përmbledhje sistematike dhe udhëzime klinike të publikuara në databaza ndërkombëtare si: ScienceDirect, Google Scholar dhe PubMed.

Këto materiale janë zgjedhur me kujdes maksimal në bazë të besueshmërisë dhe aktualitetit të tyre në diagnostikimin,

trajtimin dhe menaxhimin adekuate të sepsës dhe shokut septik.

Rezultatet dhe përfundimet

Si përfundim, diagnoza e hershme, kontrolli i burimit, terapia e përshtatshme antimikrobike dhe ringjallja fillestare janë komponentët thelbësorë të menaxhimit të sepsës dhe shokut septik, duke ndikuar ndjeshëm në rezultatet e pacientëve. Trajtimi i shpejtë me lëngje, kryesisht me kristaloide, është thelbësor për rivendosjen e perfuzionit adekuate të indeve dhe parandalimin e mosfunksionimit të organeve. Ndërsa vazopresorët luajnë një rol kyç në menaxhimin e hipotensionit të vazhdueshëm, përdorimi i tyre duhet të udhëhiqet nga monitorimi i kujdeseshëm hemodinamik. Fillimi në kohë i antibiotikëve me spektër të gjerë është po aq kritik në përmirësimin e shkallës së mbijetesës dhe nënvizon rëndësinë e adresimit të burimit të infeksionit.

Për më tepër, udhëzimet e fundit të propozuara nga IDSA30 kanë ngjallur debat brenda komunitetit mjekësor, veçanërisht në lidhje me rekomandimet për përdorimin e antibiotikëve dhe kohëzgjatjen e trajtimit. Kundërshtimet e IDSA theksojnë nevojën për një qasje të ekuilibruar ndaj terapisë antimikrobike dhe trajtimit me lëngje, duke synuar optimizimin e rezultateve të pacientëve. Ndërsa kuptimi ynë i sepsës vazhdon të evoluojë, hulumtimet dhe diskutimet e vazhdueshme rreth këtyre udhëzimeve janë thelbësore për përmirësimin e protokolleve të trajtimit dhe rritjen e kujdesit ndaj pacientit. Në fund të fundit, vendosja e udhëzimeve bazuar në prova me cilësi të lartë dhe miratimi i një qasjeje shumëplanëshe ndaj ringjalljes do të përmirësojë shanset e mbijetesës për pacientët që përballen me këtë gjendje komplekse dhe kërcënuese për jetën.

Shoku septik është një sëmundje serioze dhe, pavarësisht të gjitha përpertimeve në mjekësi, ai ende bart vdekshmëri të lartë, e cila mund të kalojë 40%. Vdekshmëria varet nga shumë faktor, duke përfshirë llojin e organizmit, ndjeshmërinë ndaj antibiotikëve, numrin e organeve të prekura dhe moshën e pacientit. Sa më shumë faktor që përputhen me SIRS, aq më e lartë është vdekshmëria. Të dhënat sugjerojnë se takipnea dhe gjendja e ndryshuar mendore janë predikues të rezultateve të dobëta. Së fundmi, përdorimi i zgjedhur i inotropeve për të ruajtur presionin e gjakut shoqërohet gjithashtu me rezultate të pafavorshme. Edhe ata që mbijetojnë mbeten me deficite të rëndësishme funksionale dhe njohëse.




Figura 4. Zinxhir për ringjalljen e sepsës, i cili përmbledhë algoritmin klinik për menaxhimin fillestar të pacientëve septikë. ICU - Njësia e Kujdesit Intensiv; MAP - Presioni Mesatar Arterial. (Burimi: Mdpi.com. [cited 2025 Oct 30]. Available from: <https://www.mdpi.com/2076-3271/6/4/91>).

Që nga lëshimi i udhëzimeve të fundit të SSC, një numër studimesh kanë ofruar informacione të reja mbi patofiziologjinë dhe trajtimin e shokut septik. Pavarësisht kësaj njohurie në rritje, menaxhimi i shokut septik mbetet një detyrë sfiduese për mjekët e emergjencës, të cilët duhet të merren me zbulimin fillestar të gjendjes dhe fazat e hershme të trajtimit. Prandaj, është me rëndësi të madhe që mjekët e emergjencës të jenë të vetëdijshëm për përparimet e fundit në

menaxhimin e pacientëve me sepsë.

Në përgjithësi, ne besojmë se një qasje sistematike që përbëhet nga zbulimi i koordinuar i pacientëve me sepsë dhe trajtimi i hershëm mund të zvogëlojë ndjeshëm vdekshmërinë e pacientëve me sepsë. Për të optimizuar më tej menaxhimin e sëmundjes, mjeku i emergjencës duhet të administrojë trajtimin duke marrë parasysh karakteristikat e pacientëve.

Tabela 1. Rekomandimet e trajtimit 3-orësh dhe 6-orësh i prezentuar nga Levy et al. (Burimi: Demir O. Sepsis: An overview of current therapies and future research. J Clin Pract Res [Internet]. 2025;47(2):99-110. Available from: <https://jcpres.com/storage/upload/pdfs/1742817107-en.pdf>).

3-hour resuscitation bundle	6-hour septic shock bundle
1. Measure initial serum lactate levels. 2. Obtain blood cultures before administering antibiotics. 3. Administer broad-spectrum antibiotics. 4. Administer 30 mL/kg of crystalloids for hypotension or lactate ≥ 4 mmol/L.	1. Administer vasopressors to maintain mean arterial pressure (MAP) ≥ 65 mmHg in patients with hypotension unresponsive to initial fluid resuscitation. 2. If persistent hypotension despite fluid resuscitation (septic shock) or lactate ≥ 4 mmol/L, measure central venous pressure (CVP) and central venous oxygen saturation (ScvO₂).

MAP: Mean arterial pressure; ScvO₂: Venous oxygen saturation; CVP: Central venous pressure.

Tabela 2. Rekomandimet mbi terapinë empirike antimikrobiale për pacientët me sepsë. (Burimi: Gauer RL. Early recognition and management of sepsis in adults: the first six hours. Am Fam Physician [Internet]. 2013 [cited 2025 Oct 30];88(1):44-53. Available from: <https://www.aafp.org/pubs/afp/issues/2013/0701/p44.html>).

Sepsis source	Recommended regimen	Comments
Community-acquired pneumonia	Vancomycin,* 1 g every 12 hours; levofloxacin (Levaquin),† 750 mg every 24 hours; and ceftriaxone (Rocephin), 2 g every 24 hours	Evaluate pleural fluid and drain empyema if present; echocardiography is needed if endocarditis with septic emboli is suspected (i.e., in intravenous drug users)
Intra-abdominal or pelvic infection	Piperacillin/tazobactam (Zosyn),‡ 4.5 g every eight hours, and gentamicin,§ 7 mg per kg every 24 hours	Obtain consultation for surgical exploration or, if indicated, imaging to identify infection source and potential for percutaneous or open drainage
Meningitis	Vancomycin, 1 g every 12 hours, and ceftriaxone, 2 g every 12 hours (and ampicillin, 2 g every four hours, if immunocompromised or older than 50 years), after intravenous dexamethasone, 10 mg every six hours	Administer acyclovir (Zovirax; 10 mg per kg every eight hours) if herpes encephalitis is suspected (e.g., altered mental status, focal neurologic abnormalities)
Skin and soft tissue infection or necrotizing infection	Vancomycin, 1 g every 12 hours; piperacillin/tazobactam,‡ 4.5 g every eight hours; and clindamycin, 900 mg every eight hours	For suspected necrotizing infections, obtain surgical consultation for tissue debridement as soon as possible
Urinary tract infection	Piperacillin/tazobactam, 4.5 g every eight hours, and gentamicin, 7 mg per kg every 24 hours	Complicated infections may be caused by <i>Enterococcus</i> species, <i>Pseudomonas aeruginosa</i> , or <i>Staphylococcus aureus</i> (non-nitrite producers), for which piperacillin/tazobactam and aminoglycoside are preferred If nitrite production or Gram stain suggest <i>Enterobacteriaceae</i> infection, can substitute fluoroquinolones or advanced-generation cephalosporins for gentamicin Perform imaging to rule out obstruction as soon as possible
Unknown infection	Vancomycin,* 1 g every 12 hours; levofloxacin,§ 750 mg every 24 hours; and ceftriaxone,§ 2 g every 24 hours	Search for a source of infection with physical examination, chest radiography, bedside ultrasonography, and urinalysis; consider abdominal or pelvic computed tomography if no source is found

Referencat:

1.Gavelli F, Castello LM, Avanzi GC. Management of sepsis and septic shock in the emergency department. Intern Emerg Med [Internet]. 2021;16(6):1649-61. Available from: <http://dx.doi.org/10.1007/s11739-021-02735-7>.

2.Carvey MMT, Glauser J. The management of severe sepsis and septic shock: A novel update and bedside reference guide. Curr Emerg Hosp Med Rep [Internet]. 2025;13(1). Available from: <http://dx.doi.org/10.1007/s40138-025-00310-4>.

3.Cabrera JL, Pinsky MR. Management of septic shock: a protocol-less approach. Crit Care [Internet]. 2015;19(1):260. Available from: <http://dx.doi.org/10.1186/s13054-015-0968-8>.

4.Evans L, Rhodes A, Alhazzani W, Antonelli M, Coopersmith CM, French C, et al. Surviving sepsis campaign: International guidelines for management of sepsis and septic shock 2021: International guidelines for management of sepsis and septic shock 2021. Crit Care Med [Internet]. 2021;49(11):e1063-143. Available from: <http://journals.lww.com/ccmjournal>.

5.Sepsistrust.org. [cited 2025 Oct 30]. Available from: <https://sepsistrust.org/wp-content/uploads/2024/07/Sepsis-Manual-7th-Edition-2024-V1.0.pdf>.

6.Demir O. Sepsis: An overview of current therapies and future research. J Clin Pract Res [Internet]. 2025;47(2):99-110. Available from: <https://jcpres.com/storage/upload/pdfs/1742817107-en.pdf>.

7.Researchgate.net. [cited 2025 Oct 30]. Available from: https://www.researchgate.net/profile/Jeremy-Richards-4/publication/262810755_Diagnosis_and_management_of_shock_in_the_emergency_department/inks/603fbc2292851c077f15c48d/Diagnosis-and-management-of-shock-in-the-emergency-department.pdf.

8.Astiz ME, Rackow EC. Septic shock. Lancet [Internet]. 1998;351(9114):1501-5. Available from: [http://dx.doi.org/10.1016/S0140-6736\(98\)01134-9](http://dx.doi.org/10.1016/S0140-6736(98)01134-9).

ATROFIA MUSKULORE SPINALE (SMA) NË KOSOVË - TË DHËNAT KLINIKE, RËNDËSIA E DIAGNOSTIKIMIT TË HERSHËM DHE QASJA E E HERSHME NË TRAJTIM ME EVRYDSI ▼ (RISDIPLAM)



Leonora Zogaj

Specialist i Pediatriisë

Abstrakt

Atrofia Muskulore Spinale (SMA) është një sëmundje gjenetike progresive e shkaktuar nga mutacionet ose deletionet në gjenin SMN1, që çojnë në mungesën e proteinës SMN dhe dëmtimin progresiv të neuroneve motorike. Trajtimi inovativ me Evrydsi (risdiplam) ka treguar përfitime klinike të qëndrueshme në të gjitha format e SMA-së, veçanërisht kur terapia fillohet në fazat e hershme të sëmundjes. Evrydsi, si një terapi orale që rrit prodhimin e proteinës SMN dhe mund të administrohet në shtëpi, ka demonstruar efekte afatgjatë pozitive në pacientët nga të gjitha grupmoshat. Diagnostikimi i hershëm, veçanërisht në fazën presimptomatike, është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve terapeutike. Për të adresuar sfidat e vonësive në diagnostikim dhe për të mundësuar ndërhyrje të shpejta, është e domosdoshme rritja e ndërgjegjësimit për shenjat dhe simptomat klinike të SMA-së, si dhe futja e skriningut neonatal. Kjo qasje do të lehtësojë zbulimin e hershëm të pacientëve dhe fillimin e menjëhershëm të trajtimit, duke maksimizuar benefitin e terapisë dhe përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës dhe prognozën e pacientëve.

Hyrje

Atrofia Muskulore Spinale (SMA) është një sëmundje gjenetike autosomale recesive dhe progresive që prek sistemin nervor motorik (1). Ajo shkaktohet nga mutacione bi-allele në gjenin SMN1, të cilat çojnë në mungesën e proteinës SMN (eng. survival motor neuron), e domosdoshme për mbijetesën e neuroneve motorike në palcën kurrizore dhe trungrun (2) (3). Mungesa e kësaj proteine shkakton degjenerim të neuroneve motorike, i cili manifestohet klinikisht me dobësi progresive muskulore, atrofi dhe, në format më të rënda, me paralizë, vështirësi në qëllitje dhe frymëmarrje, skoliozë dhe mund të çojë deri në vdekje (3) (4).

Simptomat dhe shenjat klinike të SMA-së ndryshojnë në varësi të ashpërsisë së sëmundjes

dhe moshës së fillimit, por zakonisht përfshijnë dobësi të muskujve të qafës, këmbëve dhe trupit, humbje të tonusit muskullor, refleksë të dobësuar ose mungesë refleksi, probleme me kontrollin e kokës, çrregullime të frymëmarrjes dhe në disa raste kontraktura (ngurtësim i nyjeve) (2). Në forma më të avancuara, pacientët mund të përjetojnë edhe vështirësi në qëllitje dhe të zhvillojnë deformime të shtyllës kurrizore. (1) (2)

Prevalenca globale e SMA-së vlerësohet të jetë rreth 1–2 raste për 100,000 persona, me një incidencë prej rreth 1 në 11,000 lindje të gjalla (5), ku tipi I përbën rreth 60% të rasteve (6). Në Kosovë, incidenca është 1–2 raste në vit (7) (8), megjithatë të dhënat epidemiologjike botërore shpesh janë të vjetruara dhe të kufizuara, gjë që e vështirëson vlerësimin e saktë të përhapjes së sëmundjes dhe planifikimin afatgjatë të kujdesit (4).

Klinikisht, SMA ndahet në disa nëntipe në varësi të moshës së fillimit dhe ashpërsisë së simptomave. Tipi 0 është forma më e rëndë dhe manifestohet para lindjes me lëvizshmëri të kufizuar dhe nevojë për ventilim mekanik që në lindje. Tipi I, i njohur si Werdnig-Hoffmann, shfaqet në muajt e parë të jetës dhe është zakonisht fatal për pacientët e pa trajtuar, duke u shoqëruar me dobësi të rëndë muskulore, paafësi për të mbajtur kokën, si dhe probleme serioze me frymëmarrjen dhe qëllitjen (5). Tipi II shfaqet më vonë në fëmijëri, pas 6 muajsh, dhe karakterizohet nga dobësi që kufizon ecjen (5). Tipi III, i njohur si Kugelberg-Welander, ka një fillim më të vonshëm dhe përfshin individë që mund të ecin, por dobësia motorike përparon me kalimin e kohës. Nga ana tjetër, Tipi IV është forma më e lehtë, me fillim në moshë madhore dhe jetëgjatësi normale (5).

Përveç dobësisë muskulore, pacientët përballen shpesh me komplikime ortopedike, si deformime të shtyllës kurrizore dhe kontraktura, probleme respiratore për shkak të dobësisë së muskujve të frymëmarrjes, si dhe komplikime gastrointestinale që ndikojnë në gjendjen



Figura 1. Tipet e SMA-së, shenjat dhe simptomat (Burimi: <https://doi.org/10.1016/j.ncl.2015.07.004>)

ATROFIA MUSKULORE SPINALE (SMA) NË KOSOVË - TË DHËNAT KLINIKE, RËNDËSIA E DIAGNOSTIKIMIT TË HERSHËM DHE QASJA E E HERSHME NË TRAJTIM ME EVRYDSI[▼] (risdiplam)



Shpresa Beqiri- Rashiti

Specialist i Neurologjisë

nutricionale. Këto komplikime së bashku kontribuojnë në reduktimin e jetëgjatësisë së pacientëve, sidomos në format më të rënda të sëmundjes (2).

Suksesi dhe përfitimi maksimal i trajtimit varet kryesisht nga fillimi i hershëm i tij, përpara se të ndodhë humbja e pakthyeshme e neuroneve motorike (6). Kjo është veçanërisht e rëndësishme te foshnjat me tipi I dhe II, ku humbja e neuroneve ndodh shumë shpejt, duke bërë që ndërhyrja e hershme të jetë kritike për përmirësimin e rezultateve klinike.

Të dhënat klinike nga Kosova

Të dhënat pediatrike

Momentalisht në Kosovë janë identifikuar gjithsej 11 pacientë pediatrik me SMA, me moshë të diagnostikimit që varion nga 2 muaj deri në 12 vjeç. Gjinia është e shpërndarë në mënyrë të barabartë, me 5 meshkuj dhe 6 femra. (7) Të gjithë pacientët janë homozigotë për delecionin e gjenit SMN1. Sa i përket numrit të kopjeve të gjenit SMN2, të cilat ndikojnë në ashpërsinë e sëmundjes, 9 pacientë kanë 3 deri në 4 kopje të SMN2, ndërsa dy pacientë kanë nga 2 kopje. (7) Tipet më të shpeshta të diagnostikuara në këtë grup është SMA tipi II dhe III. Në të kaluarën ka pasur më shumë raste me SMA tipi I mirëpo, në mungesë të terapisë, pacientët ose kanë ndërruar jetë, ose familjet e tyre kanë migruar për të siguruar trajtimin (7)

Të dhënat për të rriturit

Momentalisht në grupin e pacientëve të rritur janë diagnostikuar 5 individë, të gjithë meshkuj, me moshë nga 33 deri në 52 vjeç (8). Edhe këta pacientë janë homozigotë për delecionin e SMN1, ku 4 prej tyre kanë nga 3 kopje të SMN2, ndërsa një pacient ka 4 kopje të SMN2 (8). Në shumicën e rasteve, diagnoza është vendosur në moshë të rritur, madje në disa raste deri në moshën 50 vjeç, duke sugjeruar se këta persona kanë formë më të lehta të sëmundjes që nuk janë

identifikuar në kohë (8).

Evrysdi (Risdiplam): Trajtimi i vetëm i regjistruar për SMA në Kosovë me efikasitet dhe siguri të dëshmuar, i cili administrohet në mënyrë orale në shtëpi

Evrysdi është një modifikues i bashkimit të pre-mARN-së së gjenit për mbijetesën e neuronit motorik 2 (SMN2), i dizajnuar për trajtimin e atrofisë muskulore spinale (SMA) që shkaktohet nga mutacionet në gjenin SMN1 në kromozomin 5q, të cilat çojnë në mungesën e proteinës SMN. Mungesa e proteinës funksionale SMN lidhet drejtpërdrejt me patofiziologjinë e SMA-së, që përfshin humbjen progresive të neuroneve motorike dhe dobësinë muskulore (9).

Evrysdi vepron duke korrigjuar bashkimin e SMN2, duke ndryshuar ekuilibrin nga përjashtimi i ekzonit 7 në përfshirjen e tij në transkriptin e mRNA-së. Kjo çon në rritjen e prodhimit të proteinës funksionale dhe të qëndrueshme SMN. Në këtë mënyrë, Evrysdi trajton SMA-në duke rritur dhe ruajtur nivelet e proteinës funksionale SMN në organizëm (9).

Një nga avantazhet kryesore të Evrysdi është se është një molekulë e vogël që kalon barrierën gjak-tru, duke lejuar rritjen e nivelit të proteinës SMN me më shumë se dyfish brenda 4 javëve nga fillimi i trajtimit. Ky efekt ruhet deri në mënyrë të vazhdueshme, pa shenja të zbehjes së tij me kalimin e kohës. Rritja e proteinës SMN është matur në gjak dhe përfaqëson një tregues të drejtpërdrejtë të përgjigjes biologjike ndaj trajtimit (9) (10).

Efikasiteti afatgjatë i Evrysdi dhe siguria e tij është dokumentuar në studime klinike ndërkombëtare dhe studime nga praktika klinike duke u bërë i aplikueshëm për të gjitha grupmoshat, duke përfshirë infanët, fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit (9) (10) (11) (12) (13). Deri më sot, mbi 21,000 pacientë në mbarë botën janë trajtuar me Evrysdi, përfshirë 12 pacientë në Kosovë, dhe rezultatet kanë treguar përfitime afatgjata dhe të




Figura 2. Trajektorja e sëmundjes së SMA përmirësohet me fillimin në kohë të trajtimit. Nëse trajtimi fillohet herët dhe degjenerimi i neuroneve motorike nuk është i gjerë, trajtimet e disponueshme mund të ndryshojnë rrjedhën natyrale të SMA-së. (Burimi: <https://doi.org/10.1038/s41431-019-0415-4>)

Korrespondenca:
shpresabeqiri@hotmail.com

qëndrueshme në spektrin e gjerë të formave të SMA-së (7) (8) (14).

Në studimin klinik RAINBOWFISH, të gjithë infanët asimetomatikë me 2 kopje të SMN2 të trajtuar me Evrysdi arritën të uleshin pa ndihmë, ndërsa 60% e tyre mundën të ngriteshin dhe të ecnin (10). Ndërsa 100% e infanëve me tri apo më shumë kopje të SMN2 arritën të ngriteshin dhe 92% prej tyre të ecnin (10).

Në studimin FIREFISH, 62% e fëmijëve me tipi 1 SMA arritën të uleshin pa ndihmë gjatë një periudhe vëzhgimi prej mbi 5 vjetësh (11). Duke pasur parasysh natyrën e rëndë të tipit 1, 91% e këtyre fëmijëve ishin gjallë pas 5 viteve trajtim (11).

Në studimin SUNFISH, fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit me SMA (tipi II dhe III) me fillim të vonuar që morën Evrysdi për më shumë se 5 vjet shfaqën përmirësim dhe stabilitet të funksioneve motorike, duke i ndihmuar ata të përmirësojnë dhe të mbajnë pavarësinë (12).

Po ashtu, tek infanët presimetomatikë me SMA, trajtimi me Evrysdi për dy vjet ka rezultuar në aftësi normale për të qëllitur dhe ushqyer, si dhe zhvillim normal të të folurit (13). Në studimin FIREFISH, 96% e fëmijëve me tipi 1 të trajtuar me Evrysdi për më shumë se 5 vjet patën aftësi të qëllitjes pa pengesa (11).

